



Elite Travel Group



**THIRRJE PËR PJESËMARRJE
NË KONFERENCËN SHKENCORE NDËRKOMBËTARE
“Pasuritë e veçanta materiale dhe jomateriale të Shqipërisë, ofruar për
turistët vendas e të huaj”**

29 prill 2026

Tiranë, Shqipëri

• Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës

Në kuadër të projektit kërkimor PTI “Zhvillimi i turizmit të qëndrueshëm dhe marketingu digital shumëgjuhësh përmes platformës Albania 365”, i cili synon zhvillimin e një platforme digjitale shumëgjuhëshe për promovimin e burimeve turistike të Shqipërisë gjatë gjithë vitit, Fakulteti i Gjuhëve të Huaja i Universitetit të Tiranës organizon konferencën ndërkombëtare me temë “Pasuritë e veçanta materiale dhe jomateriale të Shqipërisë, ofruar për turistët vendas e të huaj” dhe shpall këtë thirrje për punime.

Shqipëria, dikur një vend i mbyllur e pak i eksploruar, përfaqëson në të vërtetë një territor me densitet të lartë trashëgimie kulturore dhe natyrore. Në të ndërthuren elemente të vendbanimeve të hershme, si Xara, Dunavec, Treni e Maliqi me elemente të qytetërimeve të mëvonshme si Butrinti, Epidamnosi/Dyrrahium/Durrësi i sotëm, Apollonia etj.; tradita të gjalla shekullore përçarë përmes elementeve kulturore e një gjuhe të mëvetësishme në grupin e gjuhëve indoevropiane; por edhe një biodiversitet i pasur. Në kushtet e zhvillimeve dinamike të turizmit global dhe të rritjes së interesit për destinacione të panjohura më parë, studimi dhe promovimi i pasurive materiale dhe jomateriale shqiptare, ofrimi i tyre nga një këndvështrim i ri dhe më tërheqës për turistët, përbën një domosdoshmëri akademike dhe strategjike.

Kjo thirrje për punime synon: të nxisë analiza ndërdisiplinore mbi identifikimin, ruajtjen, menaxhimin dhe promovimin e pasurive të veçanta të Shqipërisë; të rrisë gamën e ofertave në lidhje me pasurinë materiale e jomateriale të vendit; të paraqesë problematikat në fushën e turizmit dhe të guidave turistike, dhe të ofrojë zgjidhjet përkatëse; duke kontribuar kështu në zhvillimin e qëndrueshëm dhe inovativ të sektorit të turizmit në Shqipëri.

Konferenca mirëpret kontribute ndërdisiplinore nga fusha si turizmi, trashëgimia kulturore, historia, antropologjia, gjeografia, ekonomia, marketingu, studimet kulturore, komunikimi ndërkulturore e turistik, menaxhimi publik, arkitektura, si dhe disiplina të tjera të ndërlidhura. Kontributet mund të jenë në formën e punimeve kërkimore, studimeve të rastit, analizave krahasuese apo propozimeve për politika zhvillimore.

BOSHTET TEMATIKE

I. Risi dhe veçori të trashëgimisë materiale:

- qendrat historike dhe sitet arkeologjike;
- qytetet muze dhe qytetet e mbrojtura nga UNESCO;
- monumentet e arkitekturës tradicionale dhe fetare;
- peizazhet kulturore dhe natyrore.



Elite Travel Group



Rëndësi të veçantë merr integrimi i trashëgimisë në ofertën turistike bashkëkohore. Kontributet mund të trajtojnë çështje që lidhen me gjetje të reja, interpretimin kulturor, ruajtjen dhe restaurimin e trashëgimisë, si dhe sfidat e mbrojtjes së saj përballë turizmit masiv.

II. Trashëgimia jomateriale si përvojë turistike (për turistët vendas e të huaj):

- gjuha dhe dialektet;
- iso-polifonia shqiptare (e njohur nga UNESCO si pasuri e njerëzimit);
- folklori, vallet dhe kostumografia tradicionale;
- festat, ritualet dhe traditat lokale;
- artizanati dhe zejjet tradicionale;
- gastronomia sipas rajoneve.

Studimet mund të analizojnë mënyrat e evidentimit, interpretimit dhe promovimit të trashëgimisë jomateriale si pjesë e përvojës turistike, duke respektuar integritetin kulturor të komuniteteve lokale.

III. Qasje strategjike dhe zhvillimi i qëndrueshëm i turizmit:

- modele të zhvillimit të turizmit kulturor dhe rural;
- marketingu territorial dhe promovimi i Shqipërisë turistike;
- digjitalizimi i trashëgimisë dhe inovacioni teknologjik në këtë fushë;
- politikat publike dhe menaxhimi i qëndrueshëm i burimeve;
- roli i komuniteteve lokale në zhvillimin turistik;
- guidat, si ndërmjetës kulturorë, dhe formimi i tyre.

Kontributet mund të shqyrtojnë politika, strategji dhe modele inovative për zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit dhe për integrimin e trashëgimisë në ofertën turistike bashkëkohore.

Formati: Konferenca do të zhvillohet në format hibrid (*pjesëmarrje fizike dhe online*).

Gjuhët e prezantimit: Shqipe dhe Anglishte

Pjesëmarrja: Pa pagesë

Udhëzime për dorëzimin e punimeve

- **Abstrakti:** 250–300 fjalë
- **Fjalë kyçe:** 3–5
- **Punimi i plotë:** 5–8 faqe (A4)
- **Gjuha:** Shqip ose Anglisht
- **Formati:** Times New Roman, 12 pt, hapësirë 1.5
- **Stili i referencave:** APA (botimi më i fundit)

Të gjitha punimet do t'i nënshtrohen procesit të vlerësimit shkencor (peer-review).

- Abstraktet do të dërgohen në adresën elektronike: conference.ffl@unitir.edu.al

Afate të rëndësishme

- Dorëzimi i abstrakteve: 03.04.2026
- Njoftimi i pranimi: 10.04.2026
- Data e zhvillimit të konferencës: 29.04.2026



Elite Travel Group



- Dorëzimi i punimit të plotë: 29.05.2026

Publikimi i akteve të konferencës : Punimet e paraqitura në konferencë do të botohen në aktet e konferencës (me ISBN).

Komiteti Shkencor

- Prof. Dr. Esmeralda Kromidha – Universiteti i Tiranës, Shqipëri
- Prof. Dr. Claudia Brözel – Eberswalde University for Sustainable Development (HNEE), Gjermani
- Dr. Drita Rira – Universiteti i Tiranës, Shqipëri
- Dr. Erta Spaho – Universiteti i Tiranës, Shqipëri
- Prof. Asoc. Dr. Marsela Likaj – Universiteti i Tiranës, Shqipëri
- Prof. Asoc. Dr. Mirela Papa – Universiteti i Tiranës, Shqipëri
- Dr. Kristina Sheperi – Universiteti i Tiranës, Shqipëri
- Prof. Asoc. Dr. Alba Frashëri – Universiteti i Tiranës, Shqipëri
- Prof. Asoc. Dr. Daniela Hasa – Universiteti i Tiranës, Shqipëri
- Prof. Asoc. Dr. Flavia Kaba – Universiteti i Tiranës, Shqipëri
- Prof. Asoc. Dr. Jonida Bushi – Universiteti i Tiranës, Shqipëri
- Prof. Asoc. Dr. Adriatik Derjaj – Universiteti i Tiranës, Shqipëri
- Prof. Asoc. Dr. Sofia Delijorgji – Universiteti i Tiranës, Shqipëri
- Prof. Asoc. Dr. Anida Kisi – Universiteti i Tiranës, Shqipëri
- Prof. Dr. Enrico Lusso – Università di Torino, Itali
- Prof. Dr. Viviana Moretti – Università di Torino, Itali
- Dr. Anna Markova – Universiteti i Sofies, Bullgari
- Dr. Dhonat Kote- Universiteti i Tiranës, Shqipëri
- Prof. Dr. Valbona Berisha – Universiteti i Prishtinës, Kosovë

Komiteti Organizator

- Dr. Drita Rira
- Dr. Erta Spaho
- Silva Mullaj

Kjo konferencë synon të krijojë një platformë të qëndrueshme bashkëpunimi akademik dhe profesional për vlerësimin e pasurive të veçanta materiale dhe jomateriale të Shqipërisë mënyrën se si këto u ofrohen ose mund t'u ofrohen turistëve vendas dhe të huaj për ndërtimin e modeleve turistike konkurruese dhe të qëndrueshme.